



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Mbledhja nr. 4

Prishtinë, më 25.5. 2021, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Bekë Berisha, kryetar, Enver Dugolli, zëvendëskryetar i parë, Erxhan Galushi, nënkryetar i dytë, Arbër Rexhaj, Fatmir Humolli, Shqipe Mehmeti-Selimi, Mefail Bajqinovci, Elmi Reçica, Anton Quni dhe Slavko Simiq, anëtarë.

Mungoi: Abelard Tahiri-anëtar.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme: Xhelal Sveçla, ministër i Punëve të Brendshme, Blerim Gashani, zëvendësministër, Ferdinand Nikolla, këshilltar i ministrit.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Anita Leka, asistente e kryetarit të komisionit.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi Bekë Berisha, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e komisionit e mbajtur më datë 5.5.2021;
3. Raportimi i ministrit të Punëve të Brendshme, z. Xhelal Sveçla;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2021;
5. Të ndryshme.

Kryetari i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e komisionit e mbajtur më 5.5.2021.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Raportimi i Ministrit të Punëve të Brendshme, z. Xhelal Sveçla.

Kryetari, të nderuar anëtarë të Komisionit, sot në raportim kemi z. Xhelal Sveçla, sipas planit të punës dhe qëllimi është që të njihemi më nga afër me zhvillimet në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në agjencitë ekzekutive të saj, po ashtu me objektivat e ministrit dhe të ministrisë. Fjalën ia dha ministrit dhe më pas deputetët mund të marrin fjalën.

Xhelal Sveçla, ministër i Punëve të Brendshme, fillimisht prezantoi angazhimet dhe rezultatet konkrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që nga marrja e kësaj pozitë, më 23 mars 2021. Tutje theksoi se do të informoj për planet e ardhshme. Republika e Kosovës vazhdon të përballet me një mori rreziqesh në fushën e rendit dhe sigurisë publike dhe të cilat ministria është e angazhuar t'i adresojë me prioritet të lartë. Kosova dhe qytetarët tanë përballesh me një administratë publike jo shumë funksionale, ku kërkohet një reformim i thellë dhe modernizim. Nga marrja e detyrës, do të vazhdohet me një skanim të situatës në ministri dhe shumë probleme të identifikuar do të adresohen përmes veprimeve konkrete. Tutje përmendi disa nga sfidat, ku Policia e Kosovës vazhdon të ketë vështirësi në kryerjen e detyrave të saj, për shkak të moshës, pasi Policia e Kosovës është me moshën mesatare më të vjetër në rajon, mungesa e sigurimeve shëndetësore, ndërrimet e shpeshta të qeverisjeve, ndikimi politik, mungesa e investimeve kapitale etj. Sa i përket moshës së zyrtarëve policorë, theksoi se tashmë është projektligji i cili është në listën e prioriteteve dhe shpejt do të procedohet në Kuvend, projektligji për pensionimin e parakohshëm të zyrtarëve policorë, si dhe të Inspektoratit Policor të Kosovës. Në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka sfida, si pasojë e mungesës së reformës së brendshme dhe ka sjellë probleme në strukturat e ndryshme organizative të ministrisë. Ministria bashkë, me agjencitë e saj, janë në proces të reformës, duke ditur edhe faktin që tashmë janë të bashkuar dy ministri, ku është nxjerrë rregullorja e cila është vështirë e implementueshme dhe si e tillë do të rishikohet. Koordinimi ndërministror dhe ndërinstitutional ka munguar në zbatimin e ligjeve, strategjive dhe projekteve të ndryshme sigurisë, si strategjia e emigrimit, ekstremizmit dhe terrorizmit të dhunshëm, krimin të organizuar, menaxhimin të kufirit. Më tej, tha se është duke u punuar në zbatimin e planeve dhe reduktimin e strategjive, pasi numri i madh i tyre e ka bërë të vështirë

zbatimin e tyre. Tashmë janë formuar grupet punuese, për hartimin e strategjive të përbashkëta, pasi në total janë shtatëmbëdhjetë strategji, gjithashtu në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, ka probleme shumë të mëdha, sepse pjesëtarët janë në moshë të shtyrë, mungesa e rregullimit të statusit juridik, pajisjet e vjetruara. Sfidë në vete mbetet rendi dhe ligji në komunën veriore të vendit dhe është duke u punuar në forcimin e ligjit atje, duke qenë se problemi është disa vjeçar, zgjidhja nuk është policore, po kërkon angazhim multi-disiplinar me banorët dhe institucionet qendrore, si dhe të gjithë aktorët relevantë ndërkombëtarë. Deri tani janë bërë dy auditime të jashtëzakonshme, njëra në Qendrën për mbajtjen e të huajve dhe në proces janë katër auditime të tjera të jashtëzakonshme, njëra në menaxhimin e burimeve njerëzore, dy brenda ASHI-së dhe njëra të shërbimet e përgjithshme. Në të njëjtën kohë janë kërkuar katër inspektime të jashtëzakonshme, në kuadër të policisë nga ana e IPK-së. Tutje theksoi se në kuadër të Qeverisë Kurti, ministria ka përcaktuar qëllimet e veta strategjike që përfshijnë: parandalimin dhe luftimin e krimit, rritjen dhe ruajtjen e sigurisë publike, përmirësimin e administratës publike dhe forcimin e integritetit institucional. Në kuadër të procesit të Berlinit, më 21 maj, Qeveria ka autorizuar Ministrinë e Punëve të Brendshme, që të formojë grupe pune, që të bisedojë për dy marrëveshje, marrëveshjen ndërkombëtare për lirinë e lëvizjes dhe qëndrimin të shtetasve të Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë dhe marrëveshjen ndërkombëtare mes të Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë dhe Serbisë mbi lirinë e lëvizjes së palëve të treta. Në vijim, tha se më 18 maj e ka anuluar tenderin për furnizimin me dokumente personale identifikuese, projekt që përfshinte shpenzimin prej 21 milionë euro të taksapaguesve dhe kjo ka ndodhur pas një analize të detajuar të kryer për këtë çështje dhe kjo sepse sipas raportit të Komisionit për rishikim të procesit, planifikimet dhe argumentet për blerjen e dokumenteve ishin të pamjaftueshme dhe jo bindëse. Më 17 maj 2021, Policia e Kosovës, në bashkëpunim me DAN-amerikane dhe Guarda di Finaca dhe policinë shqiptare, ku ka rezultuar me kapjen e një sasive droge të llojit kokainë 400 kilogramësh. Polica e Kosovës është e zotuar që Kosova të mos të jetë strehë e krimit dhe kjo do të arrihet me bashkëpunim e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Më 7 maj 2021, me propozimin e ministrit Sveçla, Qeveria ka marrë vendim që shtetasit e Republikës së Shqipërisë lirohen nga obligimi për pajisje me leje pune afatshkurtër, pasi kjo marrëveshje është nënshkruar, ndërkaq Shqipëria është duke e zbatuar në përfitim të shtetasve të Kosovës që veprojnë në Shqipëri. Më 29 prill, në cilësinë e ministrit të Punëve të Brendshme, ka marrë vendim që shumë prej 2500 eurove për studentët dhe nxënësit e huaj ta zvogëlojë në vlerë prej 500 eurosh dhe të jetë qarkullim bankar jo depozitë, pasi ka qenë shuma e madhe dhe e papërbalueshme për studentë të huaj që studiojnë në Kosovë (Nga Shqipëria, Lugina e Preshevës dhe Mali i Zi). Është bërë procedimi i iniciativës për kategorizimin statusit të pikës kufitare Krushevë-Shishtavec, nga kategoria C në B dhe jemi në përfundim të marrëveshjeve bilaterale me Shqipërinë për trafikun lokal kufitar dhe për heqjen e qarkullimit të përkohshëm dhe për këtë ka realizuar vizitën në Shqipëri, ku është pritur nga homologu, Blendi Çuçi, për funksionalizimin e marrëveshjeve kufitare mes dy vendeve.

Në planin e punës janë një sërë veprimesh që janë për t'u përmbushur në kuadër të planit për njëqind ditëshin dhe që përfshin sistematizimin e shërbyesve civilë brenda MPB-së, si rezultat i bashkimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Administratës Publike, procedimi në Kuvend i Projektligjit për pensionimin e hershëm të zyrtarëve policorë dhe të IPK-së, organizimi i dy inspektimeve të tjera të jashtëzakonshme, themelimi i grupit punues për rishikimin e strategjisë kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, themelimi i grupit punues për rishikimi funksional të strategjisë për sigurinë kibernetike, themelimi i grupit punues

për hartimin e koncept-dokumentit për Projektligjin për AME, krijimin e brigadës së mbrojtjes civile, themelimi i grupit punues për rishikimin e Strategjisë së Sigurisë së Kosovës për vitet 2021-2030, marrëveshja me shtetin gjerman dhe italian, për njohjen e patent shoferëve, hartimi i strategjisë shtetërore të migrimit dhe planit të veprimit 2021-2025, themelimi i grupit punues për rishikimin e kornizës ligjore për MPB-në, themelimi i grupit punues për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL, formimi i grupit punues për plotësim-ndryshimin e Ligjit për zyrtarët publikë dhe për Ligjin për pagat.

Gjithashtu shtoi se janë të përkushtuar në arritjen e rezultateve, ofrimin e sigurisë për qytetarët, rritjen e besimit tek institucionet.

Kryetari, lidhur me raportimin e ministrit, e përgëzoi për ambiciet e shprehura, ndërkaq shtoi se shpreson që Projektligji për pensionimin e pjesëtarëve të policisë të procedohet dhe të miratohet. Tutje përmendi disa shqetësime dhe mungesa për zyrtarët policorë, siç janë, uniformat e vjetruara, çizmet, kualiteti i dobët i tyre. Gjithashtu, ka ankesa që në Gjilan objekti ku është vendosur policia është shuamë keq, Stacioni numër 3 në Prishtinë, Stacionin numër 1 ka mungesa të logjistikës, veturat e dobëta. Ndërsa është vërejtur që raporti i policisë del shumë shpejt në portale, pse ndodh kjo? Pagesat jashtë orarit nuk paguhen, konkursi në IPK është pezulluar dhe të gjithë janë UD, ndryshimet në Policinë e Kosovës, a është kjo kapje apo si? Pse është ndërruar drejtori i Policisë Kufitare, pse është ndërruar drejtori i Hetimeve, ka qenë Riza Shillova, ndërsa tash është Arben Paçarizi, për të cilin thuhet se ka dhënë informacion në kohën sa VV ka qenë në opozitë? Në bazë të cilave kritere janë ndryshuar udhëheqësit në drejtoritë rajonale? Gjithashtu, konsideroi që kriteri për përzgjedhjen e policëve është shumë i ulët, kjo çështje duhet parë më mirë.

Xhelal Sveçla, ministër i Punëve të Brendshme, në përgjigje të çështjeve të ngritura nga kryetari, theksoi e gjendja e infrastrukturës në PK nuk është e mirë, ndërkaq lajmi i mirë është që në Kodrën e Trimave shpejt do të fillojë ndërtimi i stacionit policor, pasi është zgjidhur çështja e kontestit pronësor. Qasja e ministrit është që nuk është nevoja për luks në qendër, por funksionalizimi i të gjitha stacioneve dhe shtoi se janë të përkushtuar në menaxhimin me nikoqirllëk të gjitha financave publike. Ndërsa, sa i takon shpërndarjes së informacioneve, theksoi se ka vërejtur ngecje në protokollet e sigurisë në MPB dhe për këtë qëllim është iniciuar formimi i grupit, i cili do të merret me këtë problematike për të identifikuar shkelësit potencialë. Ndërrimet që kanë ndodhur në kuadër të policisë, janë përgjegjësi e menaxhmentit të policisë, ndërkaq shtoi se Drejtoria e Inteligjencës dhe Analizës, brenda një viti ka pasur 3500 informata, ndërkaq janë 8200 policë, diku rreth 40 për qind e policëve e kanë dhënë një informatë dhe 60 për qind asnjë dhe kjo sjellë vështirësi në hetime, prandaj për këtë qëllim, policia do të fokusohet në “intelligent lead policing” dhe policia e bazuar në bashkësi, për mosfunksionimin si duhet të kërkohet përgjegjësi, ndërkaq adresimet e ardhura lidhur me moskryerjen e detyrave do ta adresojë. Ndërkaq, sa i përket kriterit të ulët për t’u bërë polic, theksoi se është agjencia e veçantë bashkë me policinë, por ka vërejtur që ka një problem në komunikim mes Akademisë për Siguri Publike dhe Policisë së Kosovës, por vlerësoi që ministria bashkë me agjencitë e saj duhet të funksionojë si ombrellë.

Enver Dugolli, lidhur me cilësinë e uniformave në Policinë e Kosovës, kërkoi që të adresohet kjo çështje, pasi është defekt i sistemit dhe duhet të zgjidhen njerëz profesionalë në komisione. Ndërsa, sa i përket anulimit të tenderit 21 milionësh, a do të ketë vonesa në prodhimin e

dokumentacionit? A ka ndonjë raport lidhur me ngjarjet në veri, ku disa qytetarë ishin duke bërë ecje dhe ka pasur të shtëna në atë zonë? Si është parë intervenimi i policisë në protestën e organizuar në Kamenicë, pasi niveli qendror thotë ndryshe dhe ai lokal ndryshe?

Xhelal Sveçla, ministër i Punëve të Brendshme, shtoi se sigurisht që gjendja e uniformave dhe të tjerave nuk është e mirë, ka vështirësi dhe proceset e tenderimit kanë probleme në të gjitha agjencitë, por janë dhënë zotime që të gjitha proceset tenderuese do të jenë të rregullat dhe furnizimi me uniforma do të jetë prioritet i ministrisë. Ndërsa, sa i përket anulimit të tenderit, theksoi se komisioni i veçantë i formuar, ka gjetur paqartësi, pasi nuk ka ndodhur analizimi i tregut dhe është optimist që nuk do të ketë vështirësi në furnizimin me dokumente të qytetarëve. Ndërsa, sa ai përket zhvillimit në veri, ku qytetarët që kanë qenë duke ecur, kanë qenë të rrezikuar, por policia është angazhuar që t'u shërbejë qytetarëve. Në fillim ka munguar raportimi nga qytetarët te policia, por pas intervistimit të tyre është shkuar në vend të ngjarjes. Ka pranuar një raport inicial dhe të tjerat janë pjesë e hetimeve të policisë dhe shpejt do dalë me rezultat konkrete. Ndërsa, sa i përket reagimit të policisë në Shipashnicë të Poshtme, theksoi se është jashtë fushëveprimit të MPB-së, ku qytetarët e pakënaqur me reformat në arsim nga kryetari i komunës protestojnë, por komisioni do të informohet me të gjeturat.

Elmi Reçica, lidhur me anulimin e tenderit, theksoi se është shumë e rëndësishme që mos të ketë vonesa për qytetarët. Sa i përket programit politik të Lëvizjes Vetëvendosje, është premtuar pensionimi i parakohshmi zyrtarëve policorë, sigurimi shëndetësor dhe zgjidhja e çështjes së zjarrfikësve. Sa është kostoja buxhetore për Projektligjin për pensionimin e parakohshëm të zyrtarëve policorë dhe të IPK-së, duke qenë se është në strategji, a figuron në kornizën afatmesme të shpenzimeve ky projektligj? Sa i përket sigurimit shëndetësor, si është menduar, si do të zgjidhet? Për zjarrfikësit, si do të rregullohet çështja e tyre dhe e statusit të tyre? A i keni parasysh rekomandimet e Raportit të Progresit për vitin 2021, të cilat janë: çështja e prekursorëve të drogave, vazhdimin e implementimit të programit për integrimin e të burgosurve dhe mbështetjes së ri-integrimit në kuadër të MPB-së; themelimi i një qendre të përbashkët për vlerësimin e kërcënimeve për nivelin e larë të terrorizmit, implementimin e planit për funksionalizimin e qendrës për funksionalizimin qendror s kufirit. Asnjë nga këto rekomandime nuk është në planin tuaj? Tek shkarkimet në Policinë e Kosovës, duke qenë se Drejtori i Policisë nuk është njeri me autoritet, mos jeni duke e përdorur këtë pafuqi të tij për të bërë shkarkime në PK? A ka pasur presion Valon Krasniqi pasi ka dhënë dorëheqje nga pozita që kishte? S i përket aplikimit në INTERPOL, a do të aplikohet apo vazhdon qëndrimi që nuk do të aplikohet në organizata ndërkombëtare? A jeni rikthyer tek mini-shengeni ballkanik? Ka informacione që ka presion mbi stafin civil përmes Sekretarit të përgjithshëm, a është e vërtetë? A keni ndërhyrë në ndonjë proces të prokurimit të policisë?

Xhelal Sveçla, ministër i Punëve të Brendshme, për pensionimin e parakohshëm të zyrtarëve policorë, theksoi se po është bërë analiza dhe është përfshirë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe për tre vite do të jetë 21 milionë euro. Pensionimi i parakohshëm afekton dy mijë policë që i bie katër gjenerata duhet të rekrutohen për të sjellë moshën mesatare nën 50, pasi aktualisht është 47 vjeç dhe sjellë vështirësi operative. Për çështjen e sigurimeve shëndetësore, janë në fazën e vlerësimeve, pasi një pjesë të madhe të përgjegjësisë e ka Ministria e Financave. Te zjarrfikësit, theksoi se e njëjta situatë e rënduar, ndërkaq përzierjen e kompetencave e sheh si problem dhe shtoi se është për kalimin tyre në nivel qendror, me memorandume bashkëpunimi

me komunat që për çështje të caktuara t'i shërbejnë interesave konkrete të komunave, por përgjegjësi të shkojë në një adresë dhe do të krijohet Brigada e Mbrojtjes Civile, me të cilët do të lirohet FSK-ja nga detyrat joushtarake. Ndërkaq, sa i përket rekomandimeve të Raportit të Progresit, për adoptimin prokurorëve për shkatërrimin e drogave, shtoi se nuk mund të japë tani përgjigjeje, por do të ofrojë përgjigje me shkrim. Ndërsa, sa i përket Qendrës për Menaxhimin e Kufirit, theksoi se kjo është një qeder e suksesit, falë ndihmës së SHB-së, janë në fazën e zgjerimit të saj. Sa i përket shkarkimeve në polici, theksoi se janë veprime të menaxhmentit, ndërsa do t'u jepet mundësi të gjithëve që janë për të punuar në funksion të zbatimit të ligjit, do të rritet llogaridhënia, do të bëhen hetimet e nevojshme bashkë me IPK-në. Ndërsa, sa i përket z. Krasniqi, theksoi se ka aktakuzë për detyrën e tij në vendin e tij të punës dhe është dashur që të transferohet dhe ky vendim është bërë nga sekretari. Sa i përket anëtarësimit në INTERPOL, theksoi se ka njoftuar ata që nuk do të aplikojnë këtë vit, pasi akoma nuk janë të përgatitur sa duhet, nuk bëhet fjalë për asnjë minishengen ballkanik, por janë bërë punë për krijimin e grupeve punuese për analizimin marrëveshjeve dhe në bazë të qëndrimeve politike do të merren vendime, pasi ka të bëjë me qarkullimin me letërnjoftim në gjashtë vende të Evropës Juglindore. Ndërsa, sa i përket presioneve ndaj administratës, theksoi se zotohet që do të ketë kërkesa strikte për të gjithë të punësuarit në MPB, në mënyrë që të kryejnë detyrat e punës. Ndërsa, a i përket ndërhyrjes në blerjet e veçanta për pajisje që i duhen policisë, theksoi se nuk është në dijeni për çfarë presioni.

Elmi Reçica, sa i përket Valon Krasniqit, e dinë të gjithë që ka aktakuzë, por a ka pasur presion nga ana politike?

Xhelal Sveçla, ministër i Punëve të Brendshme, theksoi se dallon akuza kur bëhet për vendin e punës që ushtron dhe akuza për ndonjë gjë tjetër. Për rastin në fjalë, është sekretari i Ministrisë që ka bërë transferin e tij.

Arbër Rexhaj, shtroi disa çështje për të cilat është diskutuar këto ditë. Çështja e marrëveshjeve për lëvizjen e lirë, ndërkaq minishengeni përfshin edhe lëvizjen e mallrave. Cilësimi nga U.d. i opozitës si jugosllavi e re, është e pakuptimtë, dhënia e informacioneve në faqen e ministrisë kur i referohet marrëveshjeve për lëvizje të lirë e ka këtë qëllim, për këtë arsye duhet të shpjegohet më në detaje që lëvizka e lirë, nuk e nënkupton minishengenin. Aksioni i zhvilluar më 17maj, ka qenë aksion që i ka nxjerrë Kosovës faqen e bardhë, bashkë me partnerët ndërkombëtarë, ku janë sekuestruar sasi të mëdha të kokainës. Ndërkaq, transferin për zyrtarin e ministrisë e sheh veprim të duhur, të bërë nga sekretari, përderisa i njëjti ka aktakuzë.

Xhelal Sveçla, ministër i Punëve të Brendshme, sa i përket deklarime për minishengen, theksoi se ministria është e autorizuar për të formuar grupe pune, për të analizuar marrëveshjet dhe ky është veprim i analizuar mirë, qëndrimet e tjera janë beteja politike.

Anton Quni, shtroi pyetje për ministrin, lidhur me angazhimin e zyrtarëve policorë në punë sekondare. Tutje tregoi për një rast të një zyrtari policor të njësisë speciale, i cili për të ardhura më të mira është dashur të shkojë jashtë dhe të bëjë punë, ndërkaq është kapur nga policia e shtetit, duke kryer punë e cila nuk është e lajmëruar. Si janë pagat për ta? Cilat janë kushtet e punës? Mundësia e zhvillimit në karrierë? Si do të adresohet kjo çështje?

Xhelal Sveçla, sa i përket punës sekondare për zyrtarët policorë, theksoi se kjo është e rregulluar me rregullore të brendshme të PK-së, ku janë disa lloje të punëve që mund dhe nuk mund t'i bëjnë si punë sekondare. Angazhimi i tyre vjen për shkak të nevojave ekonomike. Në Policinë e Kosovës janë disa njësi të cilat duhet të prioritizohen në paga, Drejtoria e Standardeve Profesionale duhet të ketë prioritet, ndërkaq ka zyrtarë që jetojnë përtej standardit dhe kjo çështje duhet parë, por kjo është tregues që duhet hetuar strukturat e brendshme. Sa i përket sigurisë në trafik, theksoi se është informuar që janë vetëm shtatë radarë, mungesa e flotës në polici.

Shqipe Mehmeti-Selimi, përgëzoi ministrinë dhe policinë për kapjen e bandave në trafikimin lëndëve narkotike, ndërkaq sa i përket Projektligjit për pensionimin e pjesëtarëve të policisë, theksoi se është një lajm shumë i mirë. Tutje parashtroi pyetjen: Sa vjeçar është mandati i kryeshefit të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave dhe kush e bën përzgjedhjen e kryeshefit? Ku do të jetë e vendosur Brigada e Mbrojtjes Civile, në kuadër të AME-së apo MPB-së? A keni strategji për modernizimin administratës publike?

Xhelal Sveçla, ministër i Punëve të Brendshëm, theksoi se Brigada e Mbrojtje Civile do të jetë në kuadër të AME-së, ndërsa sa i përket drejtorëve të agjencive ekzekutive, theksoi se tashmë të gjitha afatet kohore të mandateve janë tejkaluar. Kjo gjë do të rishikohet. Ndërkaq, sa i përket reformës së administratës, theksoi se janë në proces, duke qenë se janë tre ligje që rregullojnë këtë çështje.

Erxhan Galushi, falënderoi ministrin për paraqitjen e objektivave dhe planeve për ministrinë, ndërkaq kërkoi përgjegjësi dhe ndërmarrjen e masave për zyrtarët policorë, që njollosin uniformën e policisë. Gjithashtu propozoi që gjatë rekrutimit të policëve të rinj, të shikohet edhe lista rezervë nga konkursi i fundit, pasi sipas vlerësimit ata që janë në pritje janë më të mirë sesa ata që tashmë janë duke e ushtruar detyrën. Më tutje, theksoi se pret që në rekrutimin e radhës, të ketë edhe pjesëtar të komunitetit rom, pasi kjo kuotë është premtuar, pasi nuk është as afër përmbushjes dhe jemi të interesuar në përfaqësimin sa më të barabartë për të gjithë qytetarët.

Xhelal Sveçla, ministër i Punëve të Brendshme, sa i përket asaj që disa zyrtarë policorë nuk kanë sjellje të mira, shtoi se nuk duhet të bërë përgjithësim dhe duhen bërë dallimet dhe ndaj tyre të merren masa. Ndërkaq, sa i përket rekrutimit të pjesëtarëve të komunitetit rom, egjiptian dhe shkali, theksoi se nuk është përmbushur kuota e duhur. Për këtë është biseduar me drejtorin e Policisë dhe me OSBE-në, në mënyrë që në zbatimin kësaj kuote të mos ketë ulje të standardit dhe janë në bashkëpunim me OSBE-në, që të zhvillojnë një program të veçantë të para-rekrutimit, ku përveç fushatës vetëdijësuese për pjesëtarët e pakicave, të tregojnë vullnetin e tyre dhe të identifikohen vështirësitë e tyre dhe të punohet me kurse të veçanta, me qëllim të arritjes së standardit, që me meritë të pranohen në Policinë e Kosovës.

Mefail Bajqinovci, shtroi pyetje për ministrin. Ditëve të fundit është bërë një anketë lidhur me besimin e qytetarëve ndaj Policisë së Kosovës. Pyetjet ishin lidhur me parandalimin nga ana e policisë, ku 60 për qind nuk besojnë që policia parandalon. Për kënaqshmërinë janë rreth 45 për qind. Ndërkaq, 45 për qind thonë se ka korrupsion në polici. Ndërkaq, për njësitë më të korruptuara thuhet që janë, hetuesia, policia kufitare, policia e trafikut. U përmenden paqartësitë lidhur me tenderin njëzet e një milionësh. Sa duhet të jetë vlera e këtij tenderi? Sa i përket ushqimit në polici, gjithëherë ka pasur ankesa, si qëndron çështja? Si do të rregullohet çështja e

zjarrfikësve, pasi ata janë me status shërbyes civil? Dukuri shqetësuese është rekrutimi në polici, ku të gjithë fëmijët e eprorëve janë bërë policë ose është shkuar me listë, ose janë me të "mençurit" për t'u bërë. Çfarë do bëhet në luftimin nepotizmit? Ndërkaq ka zyrtarë policorë që punojnë në sektorë të caktuar dhe standardi i tyre duhet të ndërpritet.

Xhelal Sveçla, ministër i Punëve të Brendshme, tha se sa i përket tenderit 21 milionësh, komisioni është duke punuar në këtë drejtim dhe do të dalë me rekomandime. Ndërkaq, sa i përket zjarrfikësve, theksoi se ka pasur takim me Sindikatën e Zjarrfikësve dhe zgjidhja duhet të vijë bashkë me brigadën. Sa i përket rekrutimit, theksoi se ka urdhëruar katër auditime shtesë në njësitë e caktuara, por të dhëna konkrete nuk ka. Sa i përket anketës për besimin ndaj zyrtarëve policorë, theksoi se kjo tregon se duhet të merren masa që PK-ja mos të degradojë. Ndërkaq, sa i përket presionit, theksoi se nuk do të ketë asnjë presion, përveç kërkesa për përgjegjësi më të mëdha dhe më shumë punë.

Fatmir Humolli, kërkoi nga ministri që të bëhen investime në siguri, pasi kjo do të ndikonte edhe në rritjen ekonomike dhe do të ketë më shumë investitorë. Janë pikërisht njësitë intervenuese, që kanë kërkesa për t'u plotësuar kushtet e tyre, nevoja për pajisje, në mënyrë që do të mund t'u bëjnë ballë vështirësive.

Xhelal Sveçla, ministër i Punëve të Brendshme, tha se ejani duke identifikuar të gjitha objektet dhe nevojat për të gjithë agjencitë dhe institucionet vartëse. Tutje shtoi që ka paradokse që paguhet qira, ndërkaq ka hapësirë për t'u bërë zgjidhje. Kjo çështje do të analizohet drejtpërdrejt dhe për njësinë internuese. Sa i përket strukturimit ka ide që të vendosën në dy rajone.

Elmi Recica, sa i përket minishengenit, duke marrë parasysh që VV-ja ka qenë kudër kësaj ideje, ndërkaq keni përkrahur një plan marshall. Ndërkaq, asnjë pyetje nuk është bërë për të kaluarën, por vetëm për këtë periudhë. Ndërkaq, sa i përket rastit të Valon Krasniqit, me akuzë është dashur që të suspendohet e jo t'i ndërrohet vendi i punës.

Xhelal Sveçla, ministër i Punëve të Brendshme, nuk bëhet fjalë për minishengen, por për procesin e Berlinit, ndërkaq plani marshall është më i madh, ku përfshinë ekonominë dhe aspekte të tjera. Ndërkaq, pikat që jemi fokusuar si Qeveri është, lëvizja e lirë të qytetarëve me letërnjoftim. Kjo është bërë mes katër shteteve, synohet të bëhet me Bosnjë dhe Hercegovinën, ndërsa me Serbinë duhet të bëhet heqja e dokumenteve shtesë.

Kryetari, në vazhden e takimit, theksoi se në Policinë e Kosovës, nuk ka data bazë, nuk punojnë, kompjuterët, interneti, fotokopjet. Kishte rastin e fundit, për të cilin dyshon që është porositur nga politika, ku është ndaluar nga policë dhe kanë publikuar në portale lajme, etj. Ata mund që të bëjnë këtë veprim, por mund të jenë edhe të porositur politikë. Ju lutem shikojini si ministër këto gjëra? Anulimi i tenderëve, nuk është në rregull, inatet politike nuk janë në rregull, pasi qëllimi është për të bërë sa më funksionale policinë. Kjo qasje është e gabuar.

Sa i përket njësisë speciale, kanë mungesë të municionit, a është analizuar kjo? Aplikimi në INTERPOL, pse nuk po bëhet apo nga frika se nuk do të anëtarësohemi? Sa i përket Policisë Kufitare, është ndërruar komandanti, integriteti i shtetit Kosovës shkelet çdo ditë. Cili është qëndrimi politik, nëse policia e Kosovës ndeshet me xhandarmërinë serbe ose me struktura paralele?

Xhelal Sveçla, ministër i Punëve të Brendshme, tha se konstatimet nga kryetari i konsideroi të ulëta, gjoja është bërë kurdisje se është ndaluar nga policia. Sa i përket tenderëve dhe çështjes së kufijve, ekzistojnë proceduara ligjore sesi duhet të veprojnë zyrtari policor. Zyrtarët policorë do t'i trajtojnë të gjithë, në mënyrë të barabartë dhe i ka duart e lira që të zbatojnë ligjin. Ndërsa, sa i përket furnizimit me union, do të interesohet që kjo çështje do të tejkalohet.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2021

Kryetari, nëse keni propozime për planin e punës së Komisionit, ju lutem të paraqisni, nëse jo, e hedhim në votim.

Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, në këtë pikë të rendit ët ditës, me vota unanime nxori këtë:

VENDIM

Miratohet plani i punës së Komisionit për vitin 2021, i njëjti mund të plotësohet dhe të ndryshohet sipas nevojës dhe volumit të punës së Komisionit.

5. Të ndryshme

Enver Dugolli, sa i përket përzgjedhjes së komisionarit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, theksoi se kemi situatën që është marrë vendimi për shpalljen e konkursit. Ndërkaq, vendimi i dytë ka qenë formimi i panelit, është bërë lista e ngushtë e kandidatëve, që i plotësojnë kriteret. Ndërkaq, nga takimi që patëm dje, për koordinimin për procesin intervistues, ku nga opozita kishte disa qëndrime se duhet parë nga zyra ligjore, nëse përfshirja e gjithë Komisionit është në rregull. Vendimet e komisionit nuk mund të kontestohen apo analizohen, përveç nga Gjykata Kushtetuese apo nëse kërkojmë sqarime nga Kryesia. Tutje theksoi që Komisioni/Paneli duhet të procedojë dhe të caktohet data e intervistimit për kandidatët dhe të caktohen pyetjet. Gjithashtu, deklaroi se në emër të grupit të VV-së do të bëjnë vetëm një pyetje, por votimi do të bëhet nga të gjithë. Struktura e komisionit është karshi vullnetit të qytetarëve, ndërkaq është diskutuar edhe në Kryesinë e Kuvendit dhe në gjitha komisionet është duke u zhvilluar praktika e përfaqësimit, për këtë propozoi që të caktohet data për intervistë.

Kryetari, tha se gatishmërinë për përfshirjen e gjithë Komisionit në panel, e ka parë si demonstrim të forcës politike. Në takimin e djeshëm u jam lutur që të gjendet një kompromis, pasi përderisa ju i keni numrat, mund të votoni në seancë dhe kjo qasje nuk është në rregull dhe nuk mund ta përkrahim. Konsensusi i Komisionit nuk duhet të priset.

Arbër Rexhaj, tha se nga takimi i djeshëm u pa një ngritje e tensionit, të panevojshëm, konstatimet ishin që, nuk e lejon ligji përfshirjen e gjithë komisionit në panel dhe drejtimi i zyrës ligjore për mendim. Të gjitha komisionet e Kuvendit janë duke e bërë këtë praktikë, që janë të

përfshirë të gjithë në panel intervistues. Kryesia e Kuvendit ka vendim, që tashmë panelet të përbëhen nga anëtarët e komisioneve. Nuk është tendenca për arrogancë, por është diçka që i takon gjithsecilit.

Elmi Reçica, theksoi se qëndrimi i tij dhe i grupit parlamentar është i qartë. Ndërkaq, nga z. Rexhaj u tha se diçka e pavërtetë, pasi kjo çfarë po ndodh është në kundërshtim me praktikën. Kërkesa është që paneli të riformulohet me nga një përfaqësues të secilit grup parlamentar, më pas procedohet në seancë dhe nëse ka unitet mund të zgjidhet. Qëndrimi i tij dhe i grupit është i qartë që, nëse përfshihet i gjithë Komisioni në panel, deputetët e PDK-së në këtë Komision tërhiqen nga paneli.

Anton Quni, theksoi se ka qëndrimin që nëse do të përfshihet i gjithë Komisioni në panel, do të tërhiqet ky është qëndrim edhe i Grupit Parlamentar të LDK-së.

Enver Dugolli, shtoi se përfaqësimi në panel duhet të jetë në frymë me përfaqësimin qytetar në Kuvend, asgjë e jashtëligjshme nuk po bëhet, në komisione, nëse nuk e përcakton ligji nuk ka ndalesë për përbërjen e panelit.

Kryetari shtoi se do të takohet prapë me deputetët e opozitës, duke qenë se nuk janë të interesuar që të vazhdojnë si pjesë e panelit, për të parë nëse mund të zgjidhet çështja, nëse jo mund të vazhdoni punën në panel.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Bekë Berisha,
Kryetar i komisionit
